



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 91/2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur përkitazi për apelin e subjektit politik Nisma, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, më objekt të kësaj çështje juridike, anulimi i vendimit të KQZ-së, me numër 1076/2016 i datës 18.11.2016, në seancën e mbajtur me datë 19.11.2016, mori këtë:

V E N D I M

APROVOHET si i bazuar apeli subjektit politik Nisma, me seli në Prishtinë, ashtu që **ANULOHET** vendimi i KQZ-së, me numër 1076/2016 i datës 18.11.2016, dhe çështja i kthehet KQZ-së, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

PZAP-i, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 3 par. 8, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ankesën e parashtruar nga subjekti politik NISMA, me datë 18.11.2016, e ka trajtuar si apel, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar, do të trajtohet në mënyrë më të duhur si apelim, prandaj PZAP-i, tani e tutje në këtë procedurë ankesën e lart përmendur do ta trajtoi dhe procedoi si apel ndaj vendimit me numër 1076/2016 i datës 18.11.2016 të KQZ-së.

Parashtruesi i apelit, subjekti politik NISMA, me seli në Prishtinë, ka parashtruar apel në PZAP, më datë 18.11.2016, më te cilin ka kërkuar që të anulohet vendimi i KQZ-së, me numër 1076/2016 i datës 18.11.2016, sepse vendimi i lartpërmendur është në kundërshtim me nenin 20 par. 3 dhe nenin 28 par.1, të Ligjit për Zgjedhjet Përgjithshme/Lokale. Me propozim për PZAP-in, që të aprovohet apeli si i bazuar dhe të anulohet vendimi i theksuar më lart që ka të bëjë me decertifikimin e Naim Bazaj, kandidat për kryetar të Komunës së Glllogocit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit të datës 04.12.2016.

KQZ-ja, në përgjigjen në apel të datës 19.11.2016, ka theksuar se, afatet ligjore për zgjedhjet e jashtëzakonshme, siç është në rastin konkret për Kryetar të Komunës në Glllogoc, që do të mbahen me 04.12.2016, ju është referuar nenit 1 par.2, të Rregullës Zgjedhore, Nr.15/2013, në

të cilën dispozitë ligjore parashihet së KQZ-ja mund ti ndryshoj afatet kohore, për qeverisjen e zgjedhjeve. Me propozim për PZAP-in, që të refuzohet apeli i parashtruar ndaj vendimit të ankimuar dhe vendimi i KQZ-së, të mbetet ne fuqi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj pretendimet e palëve në procedurë, dhe të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjeti se **apeli është bazuar**, për këto arsye:

PZAP-i, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, për lejueshmërinë e apelit ndaj vendimit të ankimuar të KQZ-së, të parashtruar nga subjekti politik NISMA, si palë e tretë në këtë rast, ka vlerësuar se subjektit politik NISMA si person juridik, i janë prekur të drejtat ligjore me vendimin nr. 1076/2016 të datës 18.11.2016, të KQZ-së, sipas dispozitës ligjore të nenit 122 par. 1, pika c) të Ligjit për Zgjedhjet Përgjithshme/Lokale, sepse parashtruesi i apelit është në garën e njëjtë zgjedhor në Komunën Glllogoc me kandidatin e decertifikuar sipas vendimit të lartpërmendur, dhe është pjesë e përbashkët e të gjitha subjekteve politike të certifikuar nga KQZ-ja, për zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale në Komunën e Glllogocit, që do të mbahen me datë 04.12.2016. Nga kjo rezulton se çdo veprim i ndërmarrë, respektivisht vendime të marra nga KQZ-ja, ndaj njërit prej subjekteve/kandidatëve të pavarur në proces zgjedhor, të cilat i prekin të drejtat ligjore të të gjitha subjekteve/kandidatëve të pavarur mund të apeloher në PZAP përfshirë këtu rastin kur kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marre pjesë në zgjedhje, sepse të gjithë kandidatet janë certifikuar për garën dhe pozitën e njëjtë zgjedhore, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit.

Duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit nr. 1076/2016 të datës 18.11.2016, të KQZ-së, PZAP-i, ka gjetur se i njëjti nuk është në harmoni me dispozitën ligjore të nenit 20 par. 3 të Ligjit për Zgjedhjet Përgjithshme/Lokale, në të cilin parashihet se një kandidat i pavarur, nuk mund ta tërheq kandidaturën e tij para se të certifikohen rezultatet e zgjedhjeve. Për më tepër vendimi i ankimuar është në kundërshtim edhe me nenin 28 par. 1 të ligjit të njëjtë të lartpërmendur, në të cilën parashihet se subjekti/kandidati i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së, njoftimin me shkrim me të cilin shprehet qartazi, qëllimi për tërheqje, jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës për hedhjen e shortit për zgjedhje të përcaktuar sipas nenit 24.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në rastin konkret siç shihet nga vula e pranimit-protokollit dhe nga pasusi i pestë vendimit të ankimuar nr. 1076/2016 i datës 18.11.2016, të KQZ-së, kërkesa e Naim Bazaj, për tërheqja nga gara për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Glllogoc, është parashtruar vetëm një ditë më herët para hedhjes së shortit për zgjedhje, respektivisht kërkesa është dorëzuar në KQZ me datë 17.11.2016, ndërsa shorti për zgjedhje është mbajtur me datë 18.11.2016, ashtu siç është përcaktuar me vendimin e KQZ-së me nr. 893/2016 të datës 04.11.2016, e që del të jetë se kërkesa e kandidatit Naim Bazaj për tërheqja nga procesi zgjedhor është dorëzuar në KQZ në kundërshtim me dispozitën ligjore të lart theksuar.

PZAP-i, me rastin e vendosjes, për këtë çështje juridike ka marrë parasysh edhe pretendimet e KQZ-së, të parashtruar në përgjigjen në apel te datës 19.11.2016, me të cilën ka pretenduar se afatet kohore për qeverisjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme mund të ndryshohen nga KQZ-ja, duke ju referuar nenit 1 par.2 të Rregullës Zgjedhore, Nr.15/2013. Mirëpo PZAP-i, pretendimet e tilla i ka refuzuar si të pa qëndrueshme dhe te pabazuar në ligj ngase KQZ-ja me asnjë vendim apo shkresë e sidomos me vendimin për planin operacional me nr.898-2016 të datës 04.11.2016 dhe vendimin për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore me nr.893/16 të datës 04.11.2016, nuk i ka ndryshuar afatet kohore, për rastin konkret respektivisht afatin kohore me rastin e kërkesës për tërheqja nga gara për kryetar të Komunës.


Duke u nisur nga arsyet e theksuar më lart, vendimi i kundërshtuar është dashtë të anulohet dhe çështja t'i kthehet KQZ-së, në rishqyrtim dhe riprocedurë, për t'i eliminuar shkeljet esencial të dispozitave të lartë theksuara ligjore, që janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të ankimuar. KQZ-ja, në riprocedurë të kujdeset që çështja të shqyrtohet në tërësi ashtu që të merr parasysh vërejtjet e lart theksuar, pretendimet e parashtruar në apel nga parashtruesi i apelit, provat ne shkresat e lëndës dhe pas ndërmarrjes së këtyre veprimeve theksuara me lart, të merr vendim të bazuar në ligj, duke e arsyetuar marrjen e vendimit ngase në vendimin e kundërshtuar nuk ka fare arsyetim për marrjen e të njëjtit.

Andaj PZAP-i, konform dispozitave ligjore të nenit 118 par. 1 lidhur me nenin 122 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 91/2016 datë 19.11.2016

**Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani**



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi, në Gjykatën Supreme.